



Planuar / Ditevitet Planned / Pre-dated Revised / Re-dated	12.05.2022	2	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Agency Org. / Inst.	SKIMS/SHCK	2770/2022	113

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.288/2022**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci – Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.288/2022 të datës 28.03.2022 të parashtruar përmes adresës zyrtare: ankesa.kpmshek@rks-gov.net, të plotësuar me datë 12.04.2022 nga ankuesi me adresë:

kundër organit të punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 12.05.2022 mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET poshtë si e palejuar** ankesa me numër A.nr.288/2022 e datës 28.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Agjencinë e Pyjore të Kosovës sipas Akte emërimit të datës 31.01.2012 në pozitën „Zyrtar për çështje Ekonomike”, në Drejtorin Koordinuese të APK-së në Gjilan, me datë 20.01.2022, 24.01.2022, 14.03.2022 si dhe me datë 21.03.2022 ka parashtruar kërkesë për identifikimin mbi mbrojtjen e sinjalizimit, që ndërlidhen me nëpunësit civil me iniciale B.Rr; A.SH. dhe L.H të Agjencisë Pyjore të Kosovës, për t’ju shqiptuar masë disiplinore nga ana e mbikëqyrësve të tyre të drejtpërdrejtë. Ankuesi me datë 24.03.2022 ka pranuar përgjigje nga Agjencia Pyjore të Kosovës, respektivisht nga zyrtari përgjegjës për sinjalizim përmes shkresës zyrtare me numër protokollit 1/46, duke i dhënë sqarime lidhur me Ligjin Nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Ankuesi kundër përgjigjes së datës 24.03.2022 të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim të Agjencisë Pyjore të Kosovës, me datën 28.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1617/2022 përmes e-mailit zyrtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore kundër refuzimit të shqyrtimit të kërkesës për identifikimin mbi mbrojtjen e sinjalizuesve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil më datë 21.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Më datë 25.02.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencinë Pyjore të Kosovës, se bashku me shkresat e lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër Anr.288/2022 e protokolluari:1617/2022 të datës 28.03.2022 dhe e plotësuar me datës 12.04.2022; Përgjigje e datës 24.03.2022 me nr.protokolli 1/46; E-mail i datë 20.01.2022 e protokolluar me nr.232; Deklaratë e datës 29.01.2015; Kërkesë e datë 14.08.2019; E-mail i datë 15.08.2019; Deklaratë e datës 14.02.2018; E-mail i datë 13.02.2020; E-mail i datë 02.11.2019; Deklaratë e datës 04.04.2018; Raport javor i punës për periudhën 23.04.2018- 27.04.2018; E-mail i datë 27.04.2018; Kërkesë e datë 30.09.2019; E-mail i datë 25.09.2019; Kërkesë e datë 05.07.2019; E-mail i datë 05.06.2019 dhe i datës 14.06.2019; Njoftim i datë 16.10.2019; Deklaratë e datës 23.09.2019; Deklaratë e datës 01.08.2019; E-mail i datë 01.08.2019; E-mail i datë 13.02.2019; E-mail i datë 01.11.2019; Ankesa e datës 27.02.2020; E-mail i datë 27.02.2020; Njoftim i datë 01.11.2019; E-mail i datë 13.02.2020; E-mail i datë 03.11.2019; E-mail i datë 08.04.2020; Përgjigje e datës 08.04.2021 në kërkesë të datë 22.03.2021; Kërkesë e datë 22.03.2021; Kërkesë e datë 20.01.2022; E-mail i datë 19.01.2022; E-mail i datë 16.03.2021; E-mail i datë 23.03.2022; E-mail i datë 17.03.2022; Vendim i datës 18.03.2020 nr.protokolli 1241 i Komisionit Disiplinor; Vendim i datës 03.02.2020 nr.protokolli 377; Forma e përmbledhjeve të kërcënimeve e datës 31.01.2022; Kërkesë e datë 14.03.2022; E-mail i datë 31.01.2022; E-mail i datë 01.03.2023; **Përgjigje ne ankesë** e datës 19.04.2022; Akte emërimi i datës 31.01.2012 e ankuesit; Përshkrimi i detyrave të punës 15.06.2022; E-mail i datë 14.03.2022; Deklaratë e datës 04.02.2019; Shkresë për informim i datës 18.02.2020; Ankesë e datës 27.10.2009; Kërkesë e datë 24.03.2011; E-mail i datë 21.03.2021; Kërkesë e datë 21.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pa lejuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, ankuesi kundër përgjigjes së datës 24.03.2022 të zyrtarit përgjegjës për Sinjalizim në Agjencinë Pyjore të Kosovës, me datë 28.03.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar të protokolluar me numer 1617/2022, me pretendime ankimore kundër refuzimit të kërkesave të datës 20.01.2022, 24.01.2022, 14.03.2022, 21.03.2022 për identifikimin mbi Mbrojtjen e Sinjalizimit që ndërliiden me nëpunësit civil me iniciale si në vijim: B.Rr , A.SH. dhe L.H, sepse ai pretendon se është kërcënuar nga këta nëpunës gjegjesisht nuk janë marrë veprime dhe nuk i'u është shqiptuar asnjë mase disiplinore ndaj këtyre nëpunësve civil nga ana e mbikqyrësve të drejtëpërdrejtë, respektivisht ai pretendon se nuk është mbrojtur pas sinjalizimit sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe kërkon që ti njihet statusi i sinjalizuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit dhe shkresat e lëndës respektivisht përgjigjen e datës 24.03.2022 të Zyrtarit për Sinjalizim në Agjencinë Pyjore të Kosovës, lidhur me kërkesat për identifikimin mbi Mbrojtjen e Sinjalizimit ku thuhet se pretendimet e ankuesit që ai i potencon nuk qëndrojnë, dhe janë në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, ku percaktohet „ *raportimi dhe shpallja e mbrojtur* ” sepse në rastin konkret të gjitha pikat që ka informuar ankuesi nuk kanë të bëjnë fare me intersin e përgjithshëm publik, por këto pretendime përfshihen në interesin individual, gjegjesisht zyrtari përgjegjës për sinjalizim përmes kesaj përgjigjeje e ka njoftuar ankuesin se shqetesimet e tij janë individuale dhe se të njejtat nuk mund të trajohen nga Zyrtari për sinjalizim, sepse nuk janë përgjegjës dhe kompetence e tij, rrjedhimisht nuk ka autoritet ligjor që të ndërmer vendim për çështjet e ngritura të interesit individual, por ankuesi lidhur me kërcënimet që pretendon se kanë ndodhur duhet të drejtohet tek organet përgjegjëse.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar ankesën e parshtruar nga ankuesi, ka konststuar se nuk është konststuar ndonje shkeleje nga organet kompetente që ka lidhje me intersin e përgjithshëm publik dhe dhe si rredhëje e kësaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstston se ankuesit nuk i është shkeluar apo cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës ashtu sic percaktohet me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, ku theksohet se: “*Nëpunësi civil ka të*



*drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative”*

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të parashtrorjë vetëm nëpunësit civil të cilëve i'u janë shkelur të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, kështu që meqenëse ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës nuk i plotëson kushtet për parashtrim të ankesës sipas nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike, atëherë e njëjta konsiderohet se është e pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamentin Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.288/2022.**

**Zyle Millaku GOJNOVCI**

**Procesmbajtëse**

**Malsore Gashi BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit*
- *Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës.*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe,*
- *Arkivit të KPMSHC-së.*